



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI



Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 pika (c), nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040. Bazuar në nenin 25 pika 7 e Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi I Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur të dt.31.03.2017, miraton këtë:

RREGULLORE

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES KOMUNALE PËR PUNËN E KOMISIONIT PËR EMËRTIMIN, RIEMËRTIMIN E SHESHEVE, RRUGËVE, RRUGICAVE DHE VENDEVE TË TJERA PUBLIKE

Neni 1.

Qëllimi i kësaj Rregullore është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores së dt.28.03.2014 me nr. të protokollit 01-7966, Për punën e komisionit për Emërtimin, Riemërtimin e Shesheve, Rrugëve, Rrugicave dhe Vendeve të tjera publike.

Neni 2.

Te Neni 2 propozohet teksti : Gjatë Emërimit të anëtarve të Komisionit sigurohet përfaqësimi i barabartë gjinor prej 50%.

Neni 10 shtohet fjalia si në vazhdim : Komuna gjithashtu siguron njoftimin më të gjerë të publikut duke përfshirë njoftimet në zonat rurale me anë të përdorimit të mediave të shkruara si dhe mediave audio-vizuele, sikurse përdorimin e radio stacioneve si dhe shpërndarjen e njoftimeve me anë të Këshillave të Fshatrave.

Neni 21 i shtohen paragrafët 15 dhe 16.

Paragrafi 15 ka këtë përmbajtje : Komuna ka për obligim të mbajë evidencë për punën e Komisionit dhe Emertimeve të përfunduara si dhe mirëmban statistikën e ndara gjinore për emërtimet e përfunduara.

Paragrafi 16 ka këtë përmbajtje : Gjatë Emërtimeve respektohet edhe parimi i përfaqësimit të barabartë prej 50% kur është e mundur, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore.

Neni 3.

Për ekzekutimin e kësaj Rregullore do të kujdesen të gjitha organet e Administratës Komunale të Komunës së Deçanit, çdo njëra sipas kompetencave dhe fushëveprimatrisë së vet.

Neni 4.

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Neni 5.


Me Rregullore paisen:MAPL, Organet e Administratës Komunale dhe Arhivi i KK Deçan.

01.Nr.III-9

Deçan,dt.31.03.2017

HYRESE-ULAZINA-UVODNOG	
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DEÇANI - DECAN MUNICIPALITY	
Mr. Prot. No. 10260	Mr. Prot. No. 10260
From: K.R. Deçan, AS	From: K.R. Deçan, AS
No. Pages: 01	Date: 02.04.17
DECAN, DEÇANE	

Page 1 nga 1




Kryesuesi i Kuvendit:
Jashar Dobraj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI



Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 pika (c), nenit 40 paragrafi 40.2 pika (g) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, bazuar në nenin 25 pika 10 e Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi I Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur të dt.31.03.2017, miraton këtë:

RREGULLORE

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES KOMUNALE MBI LARTËSINË E TAKSAVE, NGARKESAVE, TARIFAVE DHE GJOBAVE KOMUNALE

Neni 1.

Qëllimi i kësaj Rregullore është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores së dt.29.02.2016 me nr. të protokollit 01-6496, Mbi Lartësinë e Taksave, Ngarkesave, Tarifave dhe Gjobave Komunale.

Neni 2.

Plotësohet dhe ndryshohet neni 7. i Rregullores që ka të bëjë me Tarifën Nr.1, mbi Taksat dhe Tarifat që aplikohen nga Drejtoria për Administratë të Përgjithshme.

Në Tarifën Nr.1 hiqen dy taksa Nr.23 -24 që kanë të bëjnë me Legalizimin

–**Arsyetim** : këto dy tarifa kanë kaluar në zyrën e Noterisë.

Në Tarifën Nr.1 aplikohen dispozitat e nenit 13 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2015 – ARC respektivisht dispozitat e nenit 63 të Ligjit nr.04/L003 për Gjendjen Civile që kanë të bëjnë me dispozitat ndëshkuese të Ligjit.

1. Me gjobë dënohet personi për këto shkelje :

1.1. Prej njëzetë (20) € kur nuk paraqet lindjen e fëmijës në afatin e paraparë me këtë ligj ;

1.2. Prej pesëdhjetë (50) € kur nuk lajmëron vdekjen në afatin e caktuar sipas këtij ligji;

1.3. Prej njëzetë (20) € kush kryen varrimin pa leje.(Varrezat Komunale)

2. Me gjobë do të dënohet për mos raportim të ndërsjellë në mes të organeve të përcaktuara me këtë ligj:

2.1. Prej pesëdhjetë (50) € do të dënohet zyrtari kompetent;

2.2. Prej njëqind (100) € institucioni kompetent.

Plotësohet neni 8 ku përkufizohet tarifa NR. 2 , që ka të bëjë me taksat, tarifat dhe ngarkesat që bien në kompetencën e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapsinorë.

Tarifa 2 paragrafi 2.10 i shtohet mbas pikës 11 pika 12 që përmban Dhënien e Aktit për shëndërrimin e bodrumit në Afarizëm me lartësinë e ngarkesës prej 50 €.

Ndryshohet dhe plotësohet neni 12 ku përkufizohet tarifa Nr.6, që ka të bëjë me taksat dhe ngarkesat që bien në kompetencën e drejtorisë për Shërbime Publike.

Plotësohet tarifa 6.9 mbas pikës 5 në vazhdim vendosen këto taksa:

6. Pëlqimi dhe lejen e punës për Auto-Taxi – në vit 50 €,

7. Leje për transport të udhëtarëve me Kombi-Bus – në vit 50 €,

- Page 2 nga 2



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇANI



Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 pika (c), nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040. Bazuar në nenin 25 pika 7 e Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi I Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur të dt.31.03.2017, miraton këtë:

RREGULLORE

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES KOMUNALE PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRA, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERITORIN E KOMUNËS SË DEÇANIT

Neni 1.

Ndryshohet dhe Plotësohet Rregullorja Komunale e dt.30.12.2014 me numër të protokollit 01-514, Për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në territorin e Komunës, në harmoni me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore për të përfshirë përfaqsimin gjinorë prej 50%.

Neni 2.

Neni 4 Paragrafi 1. ndryshohet duke u parafrazuar ne tekstin ne vijim:Me rastin e emërimit të përfaqësuesve të Shoqërisë Civile apo të fshatit merret mendimi i grupeve te grave deputete në Komunën përkatëse si dhe Zyrtares për Barazi Gjinore, për të siguruar përfaqësim gjinorë prej 50%, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore të Kosovës.

Neni 4 Paragrafi 5. Të shtohet pika 5.5 me tekstin si në vijim:Informatat dhe vendi i mbajtjes së tubimit duhet të jetë lehtë i qashtëm për të gjithë banorët e Komunës, duke siguruar edhe përfaqësimin e grupeve më pak të përfaqësuara sikurse personave me aftësi të kufizuara. Komuna thërret tubimet në shkolla dhe në pallatet e kulturës ku është e mundur.

Neni 5 Paragrafi 2. Plotësohet me këtë tekst:Përfaqësimi gjinorë duhet të përfshijë përfaqësimin e barabartë gjinorë prej 50%, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore të Kosovës.

Nenit 11. I shtohet Paragrafi 11.12. me këtë tekst:Këshilli Lokal gjatë ndërmarrjes së aktiviteteve merr parasyshë përfaqësimin gjinorë në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore të Kosovës, si dhe siguron integrimin e perspektivës gjinore në bashkëpunim me Zyrtaren për Barazi Gjinore.

Neni 3.

Për ekzekutimin e kësaj Rregullore do të kujdesen të gjitha organet e Administratës Komunale të Komunës së Deçanit, çdo njëra sipas kompetencave dhe fushëveprimatrisë së vet.

Neni 4.

Rregullorja hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Neni 5.

Me këtë Rregullore paisen:MAPL, Organet e Administratës Komunale dhe Arhivi i KK Deçan.

01.Nr.III-8

Deçan,dt.31.03.2017

HYRËSE-ULAZAN-JOING	
REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA E DEÇANIT • OPSTINA DEÇANE • DEÇANI MUNICIPALITY	
Nr. Prot.:	Nr. Prot.:
Dat.:	Dat.:
From:	Prot. No. 10263
Nr. I faqes:	
Br. Strukt.:	
No. Pajis.:	
01	
Data: 07.06.17	



Kryesuesi i Kuvendit:
Jashar Dobraj